



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 27.04.2026, në ora 10:00h, në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Filloreta Musaj, Rrahim Sogojeva, Laureat Gojnovci, Dardane Sogojeva Shala dhe Ali Ismaili.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Buxhet dhe Financa, Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis dhe Arianit Tërmkolli

Të tjerë: Lindita Dervisholli Prebreza - Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 17.03.2026.
2. Propozim për shqyrtimin e rritjes së të hyrave vetjake 2025 dhe bartjen e tyre për shpenzim në vitin 2026.
3. Informatë për buxhetin e shpenzuar për vitin 2025.
4. Informatë për buxhetin e shpenzuar në tremujorin e parë të vitit 2026.
5. Propozim për shqyrtimin e përmirësimit dhe harmonizimit të dokumentacionit tekstual dhe hartografik, GIS të Zonës Komerciale në Hartën Zonale të Komunale të Fushë-Kosovës.
6. Propozim për ndryshimin - revidimin e Projektit për rregullimin në rrugën Dardania në Fushë-Kosovë - trotualet, ndriçimi, sinjalizimi, infrastruktura elektrike e tjera.
7. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për taksa komunale.
8. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.
9. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës.
10. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për organizimin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës
11. Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Njesisë së Zjarrëfikësve në Fushë-Kosovë.
12. Propozim për ndryshimin e lokacionit për realizimin e projektit për renovimin e fushës së futbollit në fshatin Miradi e Epërme.
13. Propozim për shpalljen e interesit publik për zgjerimin e rrugës 'Gurët e Gjatë' në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Harilaç.
14. Shqyrtimi i kërkesës Nr. 020070/05-0012003/26, të datës 24.04.2026, për ndihmë financiare në renovimin e shtëpisë së djegur për palën Muhamet Berjani.
15. Propozim për harmonizimin e hapësirave të llogaritjes së sipërfaqeve të ndërtimit të parapara për interes public në Komunën e Fushë-Kosovës.

16. Propozim për anulimin e vendimit Nr. 76, të datës 21.05.2024, për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e shkollës së futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël.
17. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lexoi pikat e rendit të ditës dhe prezantoi pikën shtesë si vijon: Propozimin për zgjerimin e rrugës 'Gurët e Gjatë' në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Harilaç, shqyrtimin e Kërkesës për shtëpinë e djegur për palën Muhamed Berjani nga fshati Miradi e Epërme, ku duhet ta nxjerrim një 'Rekomandim për kompensim dhe ndarjen e mjeteve financiare', pastaj 'Propozimin për rregullimin e pjesë tekstuale të Hartës Zonale të Komunës' dhe 'Propozimin për shfuqizimin e vendimit për shkollën e futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël'. Hap diskutimin.

Rrahim Sogojeva: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, nga Lëvizja Vetëvendosje, pajtohem me rendin e ditës dhe pikat shtesë.

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kërkoi që të largohet nga rendi i ditës pika e dymbëdhjetë 'Propozimi për ridestininimin e fushës së futbollit nga fshati Lismir, në fshatin Miradi e Epërme', meqë projekti në fjalë është pjesë e buxhetit të planifikuar për vitin 2026, nëse kjo punë që ju po tentoni ta bëni, unë nuk e votoj, sepse është në kundërshtim me 'Ligjin për Ndarjet e Buxhetit për vitin 2026', ku kodi nuk mund të ndërrohet pa rishikim të buxhetit. Pikat shtesë duhet të analizohen, nuk janë urgjente shumica prej tyre, as pika e ndryshimit në planin urban, sikur është Harta Zonale e Komunës, as shkolla e futbollit, që po synoni ta anuloni si vendim, këto pika asnjëra nuk janë urgjente, mund të trajtohen në mbledhjen e ardhshme, mund të arsyetohet vetëm 'Kërkesa për shtëpinë e djegur për palën z. Muhamed Berjani', gjendja e të cilit është e njohur dhe dihet nga të gjithë ne.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë do ta marrë fjalën te pikat e rendit të ditës, kur vjen në shqyrtim radha e tyre.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kjo është mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa, në secilën mbledhje kemi patur pika shtesë, kjo punë nuk është në rregull fare kështu, sepse ne nuk kemi kohë, as t'i lexojmë, këtu e kemi prezentë për sqarime vetëm Drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës, për rrugën e cekur, por probleme kanë qytetarët edhe me rrugën në qytet 'Tahir Zemaj' në Fushë-Kosovës, për secilin ndryshim në plane apo rrugë të caktuara, duhet të mbahet dëgjimi publik, ne e kemi aprovuar një buxhet në Kuvendin e Komunës, nuk mund të ndryshohen kodet e projekteve. Kanë kaluar gati pesë muaj dhe ne nuk i kemi të gatshme emailat zyrtare, ato u janë hapur Ish/Asambleistëve, tani drejtor në komunë z. Mirsad Qyqalla dhe z. Durim Hajra, pse te unë është kjo vonesë, kur kam vetëm vazhdim njësoi. Ju asnjëherë si opozitë nuk i keni përkrahur pikat shtesë. Lënda për z. Muhamed Berjani është dashur të trajtohet nga Komisioni i Shëndetësisë, jo të vjen në Komitetin për Politikë dhe Financa, pa sqarime nga profesionistët, pala në fjalë ka nevojë për ndihmë, por jo në këtë mënyrë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Sqaroi pikat shtesë pse duhet të shqyrtohen, pajtohem me disa kërkesa të ngritura nga parafolësi im. Rruga 'Gurët e Gjatë' është shumë urgjente për trajtim, sepse edhe procedura e shpronësimit në fazat tjera, në vijim merrë shumë kohë dhe mund të humbet projekti në fjalë. Pala z. Muhamed Berjani i është drejtuar Kuvendit të Komunës, andaj e kam sjellë për shqyrtim, ku ne do ta delegojmë në Drejtorinë e Shëndetësisë, pastaj 'Propozimi për Hartën Zonale të Komunës', është i nevojshëm të trajtohet, sepse duhet ta bëjmë këtë ndryshim të propozuar.

Tani e qesim në votim pikën shtesë: Propozim për shpalljen e interesit publik për zgjerimin e rrugës 'Gurët e Gjatë' në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Harilaç.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave e aprovuan për shqyrtim: Propozim për shpalljen e interesit publik për zgjerimin e rrugës 'Gurët e Gjatë' në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Harilaç.

Tani e qesim në votim pikën shtesë: Shqyrtimin e Kërkesës Nr. 020070/05-0012003/26, të datës 24.04.2026, për ndihmë financiare në renovimin e shtëpisë së djegur për palën z. Muhamet Berjani nga fshati Miradi e Epërme.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me unanimitet të votave e aprovuan për shqyrtim: Kërkesën Nr. 020070/05-0012003/26, të datës 24.04.2026, për ndihmë financiare në renovimin e shtëpisë së djegur për palën z. Muhamet Berjani nga fshati Miradi e Epërme.

Tani e qesim në votim: Propozim për harmonizimin e hapësirave të llogaritjes së sipërfaqeve të ndërtimit të parapara për interes publik në Komunën e Fushë-Kosovës.

U votua me: tre votë 'për', një votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej pesë anëtarë pjesëmarrës në votim nga gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave e aprovuan për shqyrtim: Propozimin për harmonizimin e hapësirave të llogaritjes së sipërfaqeve të ndërtimit të parapara për interes publik në Komunën e Fushë-Kosovës.

Tani e qesim në votim: Propozimin për anulimin e vendimit Nr. 76, të datës 21.05.2024, për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e shkollës së futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël.

U votua me: katër vota 'për', një votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave e aprovuan për shqyrtim: Propozimin për anulimin e vendimit Nr. 76, të datës 21.05.2024, për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e shkollës së futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël.

Tani e hedhim në votim propozimin e anëtarit z. Laureat Gojnovci për largimin nga shqyrtimi të: Propozim për ndryshimin e lokacionit për realizimin e projektit për renovimin e fushës së futbollit në fshatin Miradi e Epërme.

U votua me: tre vota 'për', tre votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, meqë ishte rezultati i barabartë në votim e përdori votën e dyfishtë

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, në mungesë të votave 'për' nuk e pranuan largimin nga shqyrtimi: Propozimin për ndryshimin e lokacionit për realizimin e projektit për renovimin e fushës së futbollit në fshatin Miradi e Epërme.

Tani e hedhim në votim: Rendin e Ditës me katër pikat shtesë.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave e aprovuan për shqyrtim: Rendin e Ditës me katër pikat shtesë të aprovuara më lartë për shqyrtim.

Pika e parë (1) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 17.03.2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Aprovohet 'Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 17.03.2026'. Hap diskutimin.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e hedhi në votim për aprovim 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 17.03.2026'.

U votua unanimisht nga gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se aprovohet me unanimitet të votave 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës, e datës 17.03.2026'.

Pika e dytë (2) - Propozim për shqyrtimin e rritjes së të hyrave vetjake 2025 dhe bartjen e tyre për shpenzim në vitin 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shqyrtimin e rritjes së të hyrave vetjake 2025 dhe bartjen e tyre për shpenzim në vitin 2026', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave që të na jap sqarime.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Përsëhendes të pranishmit në mbledhje. Tani i kemi të hyrat vetjake të grumbulluara në vitin 2025, të cilat duhet të barten për shpenzim në vitin 2026, janë tre milion euro, vitin e kaluar e kemi marrë një vendim për rritjen e të hyrave vetjake në shumën e mjeteve financiare prej: 2,000,000.00€, ku prej tyre shuma prej: 575,000.00€ është tejkalim i buxhetit, që së bashku me shumën e bartjes së buxhetit të pa shpenzuar arrin në 4,000,000.00€, ku prej tyre 1,100,000.00€, shpërndahen në projekte kapitale, ndërsa 2.200,000.00€, janë mjete financiare të pa alokuara janë 643,000.00€, ku për Zyrën e Kuvendit të Komunës në kategorinë ekonomike të mallërave dhe shërbimeve ndahet shuma e mjeteve financiare prej: 65,000.00€.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes vetë vendosje, pajtohem 'Propozimin për shqyrtimin e rritjes së të hyrave vetjake 2025 dhe bartjen e tyre për shpenzim në vitin 2026', të procedohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Laureat Gojnovci: Prapë kemi mjete financiare të pa shpenzuara, sepse një shumë e konsiderueshme vjen në fund të vitit, edhe nga Gjobat e trafikut, ku përveç shumës së mjeteve financiare prej: 65,000.00€ për Kuvendin e Komunës, kemi rritje të buxhetit edhe për kategorinë ekonomike 'Paga dhe shtesa', për cilët punëtorë janë këto mjete financiare, pastaj është shuma e mjeteve financiare prej: 300,000.00€, për punësimet në kuadër të projekteve, prapë ndahen mjete financiare për asfaltim, kur ju e keni akuzuar Ekzekutivin e Komunës në vazhdimësi për asfaltim, ku pjesa më e madhe e buxhetit shkon në fshatin Bardh i Madh. E keni ndaluar punën për Stadiumin, keni premtuar ujë e pishëm, ndërsa ai mungon, andaj unë nuk do ta votoi këtë bartje të buxhetit në këtë mënyrë të shpërndarjes së tij.

Dardane Sogojeva Shala: Këtu ka mungesë të ndarjes së buxhetit për Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka pak mjete financiare për rregullimin e infrastrukturës në shkollë, kjo bartje e buxhetit është e njëjtë, me të kaluarën, me shumë pak ndryshime.

Ali Ismaili: Unë nuk do të marrë kohë shumë sot, sepse do të përsëritemi edhe në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, do ta vendos theksin në blerjen e varrezave, ku shuma është 300,000.00€, nevoja për blerjen e ngastrave kadastrale për varreza është në Fushë-Kosovë, pastaj fshatrat Miradi të Epërme dhe Sllatinë të Madhe, është premtuar zgjerimi i varrezave, por nuk është realizuar, këtu po ashtu kemi probleme të dyfishura, por nuk ndahen mjete financiare për rrugën 'Pajazit Islami' në Fushë-Kosovë. Po ashtu kemi shumë shpenzime edhe te kodi 'Shërbime kontraktuese tjera', duhet ta marrim sqarime për to, a paguhen punëtorët e projekteve, apo cilat shpenzime janë këtu.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani i kemi 300,000.00€, më herët kanë qenë vetëm katër dhjetë mijë euro, tani kjo shumë është rritur. Tani e qesim 'Propozimit për shqyrtimin e rritjes së të hyrave vetjake 2025 dhe bartjen e tyre për shpenzim në vitin 2026'.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimit për shqyrtimin e rritjes së të hyrave vetjake 2025 dhe bartjen e tyre për shpenzim në vitin 2026', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për shqyrtimin e rritjes së të hyrave vetjake 2025 dhe bartjen e tyre për shpenzim në vitin 2026'.

Pika e tretë (3) - Informatë për buxhetin e shpenzuar për vitin 2025.

Kryesues i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Informatën për buxhetin e shpenzuar për vitin 2025', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, që të japin sqarime për dy pikat tre dhe katër.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Në vitin 2025, buxheti i komunës ka qenë në shumën e mjeteve financiare prej: 16 milion euro, ku shuma prej tyre 5 milion euro janë shpenzuar për

paga dhe shtesa, ndërsa janë të bartura edhe 4 milion euro, ta gjitha shpenzimet janë të shpërndara nëpër Drejtori të Komunës, në kodet e programeve, pa hyrë në analizë të thelluar, ju shënimet i keni.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes vetë vendosje, pajtohem 'Informatë për buxhetin e shpenzuar për vitin 2025', të procedohet për shqyrtim dhe analizim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Laureat Gojnovci: Kjo informatë nuk votohet, andaj pajtohem që të procedohet për shqyrtim dhe analizim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Dardane Sogojeva Shala: Ne i kemi të dhënat për shpenzimet e vitit të kaluar, ku barten shumë mjete financiare, ndërsa nevojat për investime janë të mëdha, e këto investime nuk janë realizuar gjatë vitit të kaluar.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Ne i kemi kërkuar 80 vende të punës në arsim, ato janë lejuar nga Ministria e Arsimit, ndërsa në fund nga Ministria e Financave janë lejuar vetëm 50 vende të punës.

Ali Ismaili: Mos shpenzimi i shumës së mjeteve financiare prej: 4,000,000.00€, është për keqë ardhje. Tani e qesim 'Informatën për buxhetin e shpenzuar për vitin 2025'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës 'Informatën për buxhetin e shpenzuar për vitin 2025', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim, shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës të 'Informatës për buxhetin e shpenzuar për vitin 2025'.

Pika e katërt (4) - Informatë për buxhetin e shpenzuar në tremujorin e parë të vitit 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Informatën për buxhetin e shpenzuar në tremujorin e parë të vitit 2026', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, që të japin sqarime.

Ali Ismaili: Kodi Nr. 13460 'Shërbime kontraktuese tjera' janë në shumë të përgjithshme prej 1.7 milion euro, ndërsa nuk ka një përshkrim narrative për çka shpenzohen këto mjete financiare, prapë vazhdon qeraja për automjete

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Me këto mjete financiare paguhen punëtorët e projekteve të 'Karitasit' dhe 'Kosova - Med', pastaj kontrata tjera, DDD, mirëmbajtja e rrugëve.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të komunës, e qiti në votim për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës 'Informatën për buxhetin e shpenzuar në tremujorin e parë të vitit 2026'.

U votua me: katër vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej pesë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës 'Informatën për buxhetin e shpenzuar në tremujorin e parë të vitit 2026', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim, shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës të 'Informatës për buxhetin e shpenzuar në tremujorin e parë të vitit 2026'.

Pika e pestë (5) - Propozim për shqyrtimin e përmirësimit dhe harmonizimit të dokumentacionit tekstual dhe hartografik, GIS të Zonës Komerciale në Hartën Zonale të Komunale të Fushë-Kosovës.

Vlonjat: Propozim për shqyrtimin e përmirësimit dhe harmonizimit të dokumentacionit tekstual dhe hartografik, GIS të Zonës Komerciale në Hartën Zonale të Komunale të Fushë-Kosovës.

Filloreta: Propozim për shqyrtimin e përmirësimit dhe harmonizimit të dokumentacionit tekstual dhe hartografik, GIS të Zonës Komerciale në Hartën Zonale të Komunale të Fushë-Kosovës.

Laureat Gojnovci: Tani jemi duke folur për një temë të veq-antë, sikur është Harta Zonale e Komunës, ky ndryshim që i referohet Hartës Zonale të Komunës, si një akt administrativ, ndërsa këtu kemi të bëjmë me një dokument të planifikimit hapësinorë, ku kemi mos për puthje në mes të librës dhe pjesë dixhitale. Interferimi në sistemin GIS, ku sistemin dixhital nuk dijnë ta përdorin, propozohet ndryshimi në ZK3, ku është zero ndërtim, Ish/Kryetari i Komunës e ka marrë një vendim dhe e ka lejuar ndërtimin 0.8, ndërsa ju tani e propozoni koeficientin 1.5, këtu duhet të hapen procedurat për ndryshimin e Hartës Zonale të Komunës, ka një tendencë që në këtë rast të keni një vendim të Kuvendit të Komunës dhe kjo punë është për keqë ardhje, sepse nuk kemi të bëjmë me një akt normativ të zakonshëm, por me një dokument të planifikimit hapësinorë. Kjo është një anomali në esencën e saj.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne po tentojmë që të lehtësojmë qytetarëve zhvillimin, në mënyrë që ata të mos pësojnë si pasojë e një gabimi, ku për përmirësimin e tij, nuk po e fajësojmë askënd.

Ali Ismaili: Ne nuk po e shohim pjesën dixhitale GIS, është një material shumë i dobët bardh e zi, nuk shihet asgjë, përmendet shkresa e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, por ata theksojnë se ju mund të bëni përmirësime, por vendimi përfundimtarë dhe vlerësimi bëhet në fund nga Ministria përkatëse.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të komunës, e qiti në votim për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e përmirësimit dhe harmonizimit të dokumentacionit tekstual dhe hartografik, GIS të Zonës Komerciale në Hartën Zonale të Komunale të Fushë-Kosovës'.

U votua me: tre vota 'për', tre vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, meqë rezultati i votimit ishte i barabartë, e përdori votën e dyfishtë

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e përmirësimit dhe harmonizimit të dokumentacionit tekstual dhe hartografik, GIS të Zonës Komerciale në Hartën Zonale të Komunale të Fushë-Kosovës', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për shqyrtimin e përmirësimit dhe harmonizimit të dokumentacionit tekstual dhe hartografik, GIS të Zonës Komerciale në Hartën Zonale të Komunale të Fushë-Kosovës'.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për ndryshimin - revidimin e Projektit për rregullimin në rrugën Dardania në Fushë-Kosovë - trotualet, ndriçimi, sinjalizimi, infrastruktura elektrike e tjera.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndryshimin - revidimin e Projektit për rregullimin në rrugën 'Dardania' në Fushë-Kosovë - trotualet, ndriçimi, sinjalizimi, infrastruktura elektrike e tjera', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës që të na jap sqarime.

Drejtori për Infrastrukturë: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Projekti aktual ka qenë 4 metra gjerësi, ka patur një peticion, tani do të jetë 6 metra, aty ka probleme me furnitorët që e bëjnë furnizimin me mallëra për subjektet afariste, pastaj Kompania për pastrimin e qytetit ka telashe, andaj ne ju kërkojmë që ta na jepni një 'Rekomandim për kryerjen e këtyre ndryshimeve, brenda 10% të lejuar me kontratë, në ndryshimin e pjeshëm të rrugës në disa pjesë të saj'.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes vetë vendosje, pajtohem 'Propozimi për ndryshimin - revidimin e Projektit për rregullimin në rrugën Dardania në Fushë-Kosovë - trotualet, ndriçimi, sinjalizimi, infrastruktura elektrike e tjera', të procedohet për shqyrtim dhe analizim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Laureat Gojnovci: Për pjesën teknike e falënderoi Drejtorin për Infrastrukturë, ku projekt ka filluar me buxhetin e vitit 2025, është projekt kapitale me rëndësi të madhe që vazhdon edhe në vitin 2026, andaj ju e keni orientuar këtë propozim në Kuvendin e Komunës dhe po i kërkon këto ndryshime.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne vetëm do ta japim një rekomandim për ndryshimet e kërkuara. Materialin e keni marrë tani nga Drejtori për Infrastrukturë.

Ali Ismaili: Unë jam asamblestë në mandatin e katërt, diçka të tillë nuk kemi shqyrtuar ndonjëherë në Kuvendin e Komunës, lejohen përmirësime, por ato nuk mund të bëhen jashtë prokurimit, për secilin ndryshim duhet të mbahen dëgjime publike, ne atje e kemi një Plan të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban, ku kemi dhënë mjete financiare Kompanisë INSi për lehtësimin e qarkullimit në qytetin tonë, por nuk ka ndryshime të mëdha, deri tani në shumicën e zonave të qytetit.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të komunës, e qiti në votim për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ndryshimin - revidimin e Projektit për rregullimin në rrugën 'Dardania' në Fushë-Kosovë - trotualet, ndriçimi, sinjalizimi, infrastruktura elektrike e tjera'

U votua me: tre vota 'për', një vota 'kundër' dhe dy abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ndryshimin - revidimin e Projektit për rregullimin në rrugën 'Dardania' në Fushë-Kosovë - trotualet, ndriçimi, sinjalizimi, infrastruktura elektrike e tjera', me këtë:

Rekomandim - Propozim për ndryshimin - revidimin e Projektit për rregullimin në rrugën Dardania në Fushë-Kosovë - trotualet, ndriçimi, sinjalizimi, infrastruktura elektrike e tjera, me sugjerimin që të votohet: Rekomandim - për revidimin të Projektit për rregullimin në rrugën Dardania në Fushë-Kosovë - trotualet, ndriçimi, sinjalizimi, infrastruktura elektrike e tjera.

Pika shtatë (7) - Shqyrtimit të parë të Projekt-Rregullores për taksa komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtimit të parë të Projekt-Rregullores për taksa komunale dhe hapi diskutimin.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetë vendosje, pajtohem që shqyrtimit të parë të Projekt-Rregullores për taksa komunale, të procedohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Laureat Gojnovci: Ju e keni ftuar një takim për hartimin e katër Rregulloreve Komunale, por anëtarët e Ekzekutivit të Komunës, punën për këto rregullore e kanë vazhduar në Republikën e Shqipërisë, pa asnjë anëtarë të Kuvendit të Komunës, edhe pse i ka formuar vetë Grupet Punuese. Ne nuk jemi kundër udhëtimit zyrtar për hartimin e rregulloreve komunale, për të marrë pjesë në mandatin e kaluar, ne kemi shkuar në Prevallë, vetëm që të marrë pjesë Lëvizja Vetëvendosje, në punën e Grupeve Punuese. Përfaqësuesit tonë kanë marrë pjesë në punëtorinë një ditore në fshatin Sllatinë e Madhe në Holiday Resort, por një ditë nuk mjafton për përgatitjen e mirë të një rregulloreje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne kemi punuar së bashku në katër rregullore me rëndësi për funksionimin efektiv të komunës, kemi punuar për taksa komunale, për lejimin e rregulluar të shfrytëzimit të hapësirave publike, ndarjen e subvencioneve dhe organizimin e këshillave të lagjeve dhe fshatrave, ne jemi të hapur për ndryshime të neneve, apo paragrafeve të caktuar, nëse kemi propozime të arsyetuara.

Ali Ismaili: Unë kam qenë në rregulloren e subvencioneve, jam ftuar me sms, këto rregullore është urgjente të përgatiten dhe aprovohen sa më parë, sepse rregulloren për ndarjen e subvencioneve e kemi të vitit 2013, ka nevojë të vendosen kritere për ndarjen e subvencioneve në arsim dhe shëndetësi, por edhe në fusha tjera.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të komunës, e qiti në votim për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës 'Shqyrtimit të parë të Projekt-Rregullores për taksa komunale'.

U votua me: katër vota 'për', një vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Shqyrtimin e parë të Projekt-Rregullores për taksa komunale', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Shqyrtimit të parë të Projekt-Rregullores për taksa komunale'.

Pika e tetë (8) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtimin e parë Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të komunës, e qiti në votim për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregullorja për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike'.

U votua me: katër vota 'për', një vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Shqyrtimin e parë të Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Shqyrtimit të parë të Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike'.

Pika e nëntë (9) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtimin e parë Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të komunës, e qiti në votim për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës.

U votua me: katër vota 'për', një vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Shqyrtimin e parë të Projekt-Rregulloren për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Shqyrtimit të parë të Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës'.

Pika e dhjetë (10) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores për organizimin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtimin e parë Projekt-Rregulloren për organizimin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të komunës, e qiti në votim për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregulloren për organizimin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: katër vota 'për', një vota 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës

‘Shqyrtimin e parë të Projekt-Rregulloren për organizimin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të ‘Shqyrtimit të parë të Projekt-Rregullores për organizimin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’.

Pika e njëbëdhjetë (11) - Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Njesisë së Zjarrëfikësve në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtim ‘Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Njesisë së Zjarrëfikësve në Fushë-Kosovë’, ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe mjedis që të na jap sqarime.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Ju e dini që Agjensia për Menaxhimin e Emërgjencave, nuk e ka dhënë pëlqimin për ndërtimin e objektit për Njësine e Zjarrëfikësve në fshatin Pomozotin, meqë gjindet larg qytetit, ne propozojmë që ky objekt të ndërtohet në qytet, në lagjen e Bresjes, afër rrugës kryesore, në pjesën ku janë drutë tani, ku ndërtim do të financohet nga Agjensia për Menaxhimin e Emërgjencave, ku ne pritet të kemi 41 zjarrëfikës, andaj unë ju ftoi që të na përkrahni në këtë proces të punës.

Filloreta Musaj: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetë vendosje, pajtohem që ‘Propozimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Njesisë së Zjarrëfikësve në Fushë-Kosovë’.

Laureat Gojnovci: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, pajtohem që ‘Propozimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Njesisë së Zjarrëfikësve në Fushë-Kosovë’.

Ali Ismaili: Ekipi profesional nuk ka pranuar që ky objekt të jetë në fshatin Pomozotin, për arsye të vonesave në intervenimet në qytet, unë e kam kërkuar atë ngastër kadastrale për objektin e Xhamisë, por nuk kam gjetur përkrahje. Unë ju përkrah në realizimin e secilit projekt kapital në interesin e qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të komunës, e qiti në votim për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Njesisë së Zjarrëfikësve në Fushë-Kosovë’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Njesisë së Zjarrëfikësve në Fushë-Kosovë’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim, shqyrtim dhe analizim në Kuvendin e Komunës të ‘Propozimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Njesisë së Zjarrëfikësve në Fushë-Kosovë’.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Propozim për ndryshimin e lokacionit për realizimin e projektit për renovimin e fushës së futbollit në fshatin Miradi e Epërme.

Propozim për ndryshimin e lokacionit për realizimin e projektit për renovimin e fushës së futbollit në fshatin Miradi e Epërme.

Laureat Gojnovci: Ndryshimi i projektit kapital dhe largimi i projektit të fushës së futbollit nga fshati Lismir dhe dërgimin e tij në fshatin Miradi e Epërme, unë nuk pajtohem, sepse ju po bëni ndryshimin e kodeve të projekteve të miratuara, edhe në Buxhetin e Kosovës, ju nuk mund ta ndryshoni 'Ligjin për ndarjen e buxhetit për vitin 2026'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Aty planifikohet të ndërtohet impianti, ju keni vendosur një projekt në mënyrë të gabuar, në vendin e caktuar për një projekt tjetër kapital.

Ali Ismaili: Këtë propozim duhet të na arsyeton Drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nuk ndryshohet një projekt me dy rreshta, duhet të kemi shpjegime të qarta nga propozuesi.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të komunës, e qiti në votim për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ndryshimin e lokacionit për realizimin e projektit për renovimin e fushës së futbollit me bari sintetik në fshatin Miradi e Epërme'.

U votua me: tre vota 'për', tre vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës meqë votimi ishte i barabartë e përdori votën e dyfishtë/

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ndryshimin e lokacionit për realizimin e projektit për renovimin e fushës së futbollit me bari sintetik në fshatin Miradi e Epërme', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për ndryshimin e lokacionit për realizimin e projektit për renovimin e fushës së futbollit me bari sintetik në fshatin Miradi e Epërme'.

Pika e trembëdhjetë (13) - Propozim për shpalljen e interesit publik për zgjerimin e rrugës 'Gurët e Gjatë' në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Harilaç.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shpalljen e interesit publik për zgjerimin e rrugës 'Gurët e Gjatë' në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Harilaç', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës që të na jap sqarime.

Drejtori për Infrastrukturë: Rruga 'Gurët e Gjatë', është e domosdoshme të realizohet këtë vitë, por nevojitet shpallja e interesit publik, pastaj zhvillimin e procedurave të shpronësimit të disa pronave për këtë rrugë.

Pati edhe diskutime dhe sqarime tjera pas të cilave Kryesuesi i Kuvendit të komunës, e qiti në votim për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shpalljen e interesit publik për zgjerimin e rrugës 'Gurët e Gjatë' në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Harilaç'.

U votua me: katër vota 'për', një votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës

‘Propozimin për shpalljen e interesit publik për zgjerimin e rrugës ‘Gurët e Gjatë’ në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Harilaç’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të ‘Propozimit për shpalljen e interesit publik për zgjerimin e rrugës ‘Gurët e Gjatë’ në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Harilaç’.

Pika e katërbëdhjetë (14) - Shqyrtimi i kërkesës Nr. 020070/05-0012003/26, të datës 24.04.2026, për ndihmë financiare në renovimin e shtëpisë së djegur për palën Muhamet Berjani.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi shqyrtimin e Kërkesës Nr. 020070/05-0012003/26, të datës 24.04.2026, për ndihmë financiare në renovimin e shtëpisë së djegur për palën z. Muhamet Berjani nga fshati Miradi e Epërme.

Pati edhe diskutime dhe sqarime tjera pas të cilave Kryesuesi i Kuvendit të komunës, e qiti në votim për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës ‘Shqyrtimin e Kërkesës Nr. 020070/05-0012003/26, të datës 24.04.2026, për ndihmë financiare në renovimin e shtëpisë së djegur për palën z. Muhamet Berjani nga fshati Miradi e Epërme’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Shqyrtimin e Kërkesës Nr. 020070/05-0012003/26, të datës 24.04.2026, për ndihmë financiare në renovimin e shtëpisë së djegur për palën z. Muhamet Berjani nga fshati Miradi e Epërme’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të ‘Kërkesës Nr. 020070/05-0012003/26, të datës 24.04.2026, për ndihmë financiare në renovimin e shtëpisë së djegur për palën Muhamet Berjani’, me sugjerimin që kjo çështje të trajtohet në Komisionin për ndarjen e subvencioneve në shëndetësi dhe mirëqenie sociale, në përputhje me mundësitë buxhetore në kategorinë e subvencioneve.

Pika e pesëmbëdhjetë (15) - Propozim për harmonizimin e hapësirave të llogaritjes së sipërfaqeve të ndërtimit të parapara për interes publik në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Sqaroi Propozimin për harmonizimin e hapësirave të llogaritjes së sipërfaqeve të ndërtimit të parapara për interes publik në Komunën e Fushë-Kosovës. Pati edhe diskutime dhe sqarime tjera pas të cilave Kryesuesi i Kuvendit të komunës, e qiti në votim për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për harmonizimin e hapësirave të llogaritjes së sipërfaqeve të ndërtimit të parapara për interes publik në Komunën e Fushë-Kosovës’.

U votua me: tre vota ‘për’, dy vota ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me shumicë të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës

‘Propozimin për harmonizimin e hapësirave të llogaritjes së sipërfaqeve të ndërtimit të parapara për interes publik në Komunën e Fushë-Kosovës’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të ‘Propozimit për harmonizimin e hapësirave të llogaritjes së sipërfaqeve të ndërtimit të parapara për interes publik në Komunën e Fushë-Kosovës.

Pika e gjashtëmbëdhjetë (16) - Propozim për anulimin e vendimit Nr. 76, të datës 21.05.2024, për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e shkollës së futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për anulimin e vendimit Nr. 76, të datës 21.05.2024, për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e shkollës së futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël’.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të komunës, e qiti në votim për shqyrtim dhe procedim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për anulimin e vendimit Nr. 76, të datës 21.05.2024, për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e shkollës së futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej katër nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës ‘Propozimin për anulimin e vendimit Nr. 76, të datës 21.05.2024, për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e shkollës së futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël’, me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të ‘Propozimit për anulimin e vendimit Nr. 76, të datës 21.05.2024, për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e shkollës së futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël’.

Pika e shtatëmbëdhjetë (17) - Të Ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: A keni dikush për të shtruar ndonjë çështje për diskutim. Nëse jo atëherë falënderit shumë, shihemi në mbledhjen e radhës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 11:55 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlontat Hasani

